



VOZITJE E SIGURTË



SAFETY MATTERS
SIGURIA MBI TË GJITHA
SIGURNOST PRE SVEGA



QEVERIA E KOSOVËS
MINISTRA E PUNËVE TË MBRENDSHME

Mbështetur nga: UNDP,
Qeveria e Belgjikës, Qeveria e Danimarkës, Qeveria e Luksemburgut,
Qeveria e Holandës dhe Qeveria e Suedisë.

Ngasja e sigurt në rrugët e ngrira

1. Zvogëlo shpejtësinë dhe lejo vetes shumë hapësirë për tu ndalur. Duhet të leni së paku tri herë më shumë hapësirë sesa zakonisht në mes juve dhe automjetit përpara.
2. Freno lehtë për të shmangur rrëshqitjen. Nëse rrotat fillojnë të bllokohen (rrëshqasin) zbut frenimin.
3. Ndezi dritat për të përmirësuar pamjen për automobilistët tjerë.
4. Dritat dhe xhami i përpamë duhet të jenë të pastra.
5. Përdor shpejtësi (marsh) më të ulët, në veçanti nëpër kodra.
6. Mos përdor kontroll të shpejtësisë dhe mos tepro me ngasje në rrugë e ngrira.
7. Kushto kujdes të veçantë mbi ura, mbikalime dhe nëpër rrugë të pafrekuentuara të cilat ngrihen të parat. Bile edhe në temperaturë mbi temperaturë të ngrirjes, në kushte të lagështa, mund të përballeni me akull në zona të mbuluara nga hija, ose në rrugë të ekspozuara siç janë urat.
8. Mos tejkallo pastruesit e borës dhe kamionët me kripë. Ngasësit kanë pamje të kufizuar, dhe ka gjasa që rruga para tyre të jetë në gjendje më të rëndë sesa rruga prapa tyre.
9. Mos supozo se automjeti juaj mund të përballojë të gjitha kushtet. Edhe automjetet me tërheqje me katër rrotë dhe ato me tërheqje me rrotë të përparme mund të përballen me telashe nëpër rrugë gjatë dimrit.

Nëse rrëshqasin rrotat e prapme...

1. Largoje këmbën nga gazi.
2. Drejtoje automjetin në drejtimin që dëshironi të shkojnë rrotat e përparme. Nëse rrotat e prapme rrëshqasin majtas, drejto timonin majtas. Nëse ato rrëshqasin djathtas, drejto djathtas.
3. Nëse rrotat e prapme rrëshqasin në anën tjetër kur të kthehesh në rrugë, lehtë drejto timonin në atë anë. Ndoshta do të kërkohet që të drejtosh timon majtas djathtas disa herë gjersa të vësh automjetin plotësisht nën kontroll.



VOZITJE E SIGURTË

4. Nëse keni frena standarde, pompoi lehtë.
5. Nëse keni frena kundër bllokimit (ABS), mos pompo frenat. Apliko presion të vazhdueshëm mbi frena. Do të ndjeni pulsul e frenave, që është normale.

Nëse rrëshqasin rrotat e përparme...

1. Largo këmbën nga gazi dhe drejtoje veturën menjëherë.
2. Kur të rrëshqasin rrotat për trotuari, ato ngadalësojnë automjetin dhe ulin marshin

(shpejtësinë). Kur të ndodh kjo, drejto timon në drejtimin e dëshiruar. Më pas vendose ndërruesin e shpejtësive në D, ose liroje pedalin e fraksionit, dhe shpejto lehtë.

Nëse bllokohesh...

1. Mos vërtit rrotat në vend. Kjo vetëm do të gropos rrotën tutje.
2. Kthe rrotat nga njëra anë në tjetrën për të shtyrë borën nga rruga.
3. Shtype gazin lehtë për të nxjerrë automjetin.
4. Përdor lopatën për të pastruar borën nga rrotat dhe pjesa nën automjet.
5. Qit zall, dhé, rërë ose krip në shtegun e rrotave për të ndihmuar tërheqjen.
6. Provo tundimin e automjetit (së pari lexo doracakun e automjetit sepse të disa automjete kjo mund të dëmtojë kutinë e shpejtësive). Nga përpara vendose në marshin e prapëm (rikverc) dhe përsërite prapë. Çdo herë kur te futë në shpejtësi, jepi pak gaz gjersa automjeti të fillojë të lëvizë.